



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 03 , dt. 15.06.2022

MBI RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 13 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e strukturës organizative, klasifikimin nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut per vitin 2022”, me propozim të Kryesisë , Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratojë riorganizimin e Strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022 te rishikuar sipas tabelës bashkangjitur.
2. Efektet financiare do të perballohen brenda fondit te pagave të miratuar për vitin 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi O.Beqiraj
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.Qarkut B. Muço



**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË
KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022**

V.K.M.177 dt 08.03.2017 Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin 165 dt. 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Për grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e të punonjësve administrative të njesive të qeverisjes vendore"

Nr.	Njësia strukturore	Nr puno-njësve	Niveli Lidhja 7	Paga Gr, sipas Kat.diplom	Paga e grupit	Vjetërsi 2%	Paga e pozicionit	Statusi I punonjesit	
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	1/e				150000	Të zgjedhur	
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	1/e				101650	Të zgjedhur	
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	I-b	1	14000	2%	80000	Të emeruar K.Qarkut	
IV	Kabineti I Kryetarit								
	Drejtor I kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik	1	I-b	1	14000	2%	91600	Pozicion pune me kontratë	
	Keshilltar i maredhenieve me publikun dhe mediat	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	73000	Pozicion pune me kontratë	
	Keshilltar per Projektet e Bashkimit Europian	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	79600	Pozicion pune me kontratë	
	Zedhenes i zyres se Kryetarit dhe sherbime te tjera	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	51000	Pozicion pune me kontratë	
V	Sektori i finances, zhvillimit ekonomik, sherbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit te territorit								
	Pergjegjes I Sektorit te Finances dhe Buxhetit	1	III-a/1	1	14000	2%	69800	Pozicion pune shërbimi civil	
	Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerezore dhe Emergjencat Civile	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil	
	Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil	
	Specialist I nivelit te larte per programet e zhvillimit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil	
	Specialist per Shendetsine dhe Ceshjet sociale, arsimin dhe Kulturen	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	61000	Pozicion pune shërbimi civil	
	Shofer autoveture I institucionit	1	P.19/20				39000	Pozicion pune me kontratë	
	Totali Administrata	13							

Kryetar Këshillit të Qarkut
Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS, TE KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022 TE RISHIKUAR

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165 date 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 13 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e riorganizimit të strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut.

Propozojmë riorganizimin e “Drejtorisë të Financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit” në “Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit” në kuadër të unifikimit të Strukturave Organizative në të gjitha Këshillat e Qarqeve. Ndryshimet do të bëhen brenda numrit të Administratës të miratuar në Ligjin e Buxhetit. Niveli i pagave do të jetë ai i miratuar me Vendim të Këshillit të Qarkut 7 dt. 26.04.2017 dhe referuar VKM nr. 177 dt. 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 165 dt. 02.03.2016. Miratimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë efekte financiare në rritje të fondit të pagës dhe sigurimeve shoqërore të miratuar për vitin 2022.

Sa më sipër paraqesim për miratim strukturën organizative dhe klasifikim e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2022 të rishikuar sipas tabelës bashkangjitur.

Korçë, me 08.06.2022

Oljona Beqiraj

Specialist i burimeve njerëzore